




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 05.08.2015

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.07.2015, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 742, të datës 21.07.2015, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, në lidhje me kërkesën Nr. 05-350-11457 të datës 04.05.2015, të paraqitur nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet, kërkesa Nr. 05-350-11457, e datës 04.05.2015, nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë, për rrënimin e objektit të vjetër të xhamisë i ndërtuar në ngastrën kadastrale Nr. P-725140036-00636-1, në zonën kadastrale në Fushë-Kosovë në rrugën 'Nënë Tereza'.
2. Në ngastrën kadastrale Nr. P-725140036-00636-1, në zonën kadastrale në Fushë-Kosovë, në sipërfaqe prej 1129m² në vendin e quajtur 'Selo kuqni plac' e evidentuar sipas certifikatës Nr. 25-3529, në rrugën 'Nënë Tereza' në Fushë-Kosovë, i lejohet Këshillit të Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë, ndërtimi i objektit të ri të xhamisë, në përputhje me Planin Zhvillimor Urban dhe Planin Rregullues.
3. Mbikëqyrja e punëve të rrënit të objektit të vjetër, punëve të ndërtimit të objektit të ri dhe procedurave tjera, konform Planit Zhvillimor Urban, Planit Rregullues dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi, është në kompetencën e Drejtorisë së Planifikimit Urban, Drejtorisë së Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronës dhe Drejtorisë së Inspektoratit.
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditë e aprovimit, nga Kuvendi Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së GJKP, Drejtorisë së INSPK, Këshillit të Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë dhe Arkivës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Mr./Jaq/Vicetr. <u>106</u>
Data/Datum <u>10. 08. 2015</u>

Datë: 07.08.2015

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.07.2015, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 487, të datës 21.07.2015, paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, Nenin 13, paragrafi 3, të 'Rregullores për ndarjen e subvencioneve', Nr. 83, të datës 14.06.2013, mori:

V E N D I M

1. Lejohen mjetet financiare, në shumë prej 7000€, për Hasan Krasniqi, me destinim për të ndihmuar në mbulimin e shpenzimeve për intervenim shëndetësor nga sëmundja me Dg. Tachycardia Paroxizmalis Supraventikularis, në spitalin e Augsburgut të Gjermanisë.
2. Është në kompetencë të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit që të sigurojë mjetet financiare sipas pikës një (1) të vendimit.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së SHMS, Drejtorisë së FB, Palës dhe Arkivës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA	OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRIM	
Nrfaq/Nr.str.	107
Data/Uatm.	10. 08. 2015
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE	



Datë: 07.08.2015

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.07.2015, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 490, të datës 22.07.2015, paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, Nenin 3, Nenin 4, të 'Rregullores për ndarjen e subvencioneve', Nr. 83, të datës 14.06.2013, mori:

V E N D I M

1. Lejohen mjetet financiare, në shumë prej 2500€, për Organizatën Joqeveritare 'Amici De Bambini', me destinim për mbulimin e shpenzimeve për veprimtarinë dhe aktivitetet e Organizatës, lidhur me rehabilitimin dhe resocializimin e fëmijëve, pa prindër dhe të traumatizuar.
2. Është në kompetencë të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit që të sigurojë mjetet financiare sipas pikës një (1) të vendimit.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së SHMS, Drejtorisë së FB dhe Arkivës.




Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi

[Signature]



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVSKO POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVOPOLJE



Datë: 07.08.2015

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.07.2015, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 560, të datës 26.05.2015, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. I lejohej Drejtorisë së Arsimit menaxhimi i sallave të sportit, fushave të sportit dhe hapësirave publike, në pronësi të shkollave, sipas nevojave të tyre.
2. Në menaxhimin e sallave të sportit, fushave të sportit dhe hapësirave publike përfshihen objektet si në vijim:
 - 2.1 Salla e sportit në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët 'Zejnel Salihu', në fshatin Bardh i Madh;
 - 2.2 Salla e sportit në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët 'Bajram Curri', në fshatin Sllatinë e Madhe;
 - 2.3 Salla e sportit në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno', në Fushë-Kosovë;
 - 2.4 Salla e sportit në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët 'Daut Bogujevci', në Fushë-Kosovë;
 - 2.5 Fusha e sportit në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno', në Fushë-Kosovë;
 - 2.6 Fusha e sportit në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët 'Selman Riza', në Fushë-Kosovë;
 - 2.7 Fusha e sportit në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët 'Daut Bogujevci', në Fushë-Kosovë;
 - 2.8 Fusha e sportit në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët 'Zejnel Salihu', në fshatin Bardh i Madh;
 - 2.9 Fusha e sportit në paralelen e ndarë të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Zejnel Salihu', në fshatin Bardh i Vogël;

- 2.10 Fusha e sportit në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët 'Bajram Curri', në fshatin Sllatinë e Madhe;
- 2.11 Fusha e sportit në paralelen e ndarë të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Bajram Curri', në fshatin Harilaq;
- 2.12 Fusha e sportit në paralelen e ndarë të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Bajram Curri', në fshatin Henc;
- 2.13 Fusha e sportit në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët 'Vëllezërit Frashëri', në fshatin Miradi e Poshtme;
- 2.14 Fusha e sportit në paralelen e ndarë të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Vëllezërit Frashëri', në fshatin Miradi e Epërme;
- 2.15 Fusha e sportit në paralelen e ndarë të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Vëllezërit Frashëri', në fshatin Vragoli;
- 2.16 Fusha e sportit në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët 'Laura Scotti', në fshatin Graboc i Poshtëm;
- 2.17 Fusha e sportit në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët 'Lismiri', në fshatin Lismir.
3. I lejohej, Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit menaxhimi i objekteve sportive si në vijim:
- 3.1 Salla e sportit e qytetit të Fushë-Kosovës;
- 3.2 Kompleksi rekreativo sportiv i fushave të sportit në fshatin Sllatinë e Vogël.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e vendimit është në Kompetencë të Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
5. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi Komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së KPS dhe Arkivës.**




**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi**



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË / KOSOVO POLJE



Datë: 07.08.2015

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.07.2015, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 491, të datës 22.07.2015, paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 3, paragrafi 1, pika 1.3, Nenin 4, Nenin 5, Nenin 7, Nenin 8, të 'Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale' Nr. 04/L-144 (Gazeta Zyrtare Nr. 35/2012), Nenin 2, Nenin 4, të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale, Nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për fillimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) vite, të Ngastrës Kadastrale Nr. P-72514010-00815-0, në sipërfaqe prej 2750m², në vendin e quajtur "Selo Selo", e evidentuar në Fletën Poseduese, me numër të certifikatës Nr.25-3923, në Zonën Kadastrale Bardh i Madh, përmes procedurës së ankandit publik.
2. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, të cekur në pikën një (1) të vendimit, është biznes - zhvillim.
3. Për dhënien në shfrytëzim të ngastrave kadastrale, të cekur në pikën një (1) të vendimit, formohet 'Komisioni për vlerësimin e ofertave', në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve:
 - 3.1. Bedri Krasniqi - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i LDK-së;
 - 3.2. Ali Ismaili - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i PD-së;
 - 3.3. Qerim Gara - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i PDAK-së;
 - 3.4. Abaz Xhigoli - Drejtor i Qendrës për Punë Sociale;
 - 3.5. Vlora Berjani - Zyrtare e Arsimit;
 - 3.6. Shkëlzen Berisha - Zyrtar për Financa në Arsim;
 - 3.7. Isuf Qerimi - Përfaqësues i Shoqërisë Civile.
4. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit është që të bëjë vlerësimin e ofertave dhe ofertat ekonomikisht më të favorshme, në pajtim me kriteret e përcaktuara me dispozitat ligjore

për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, i propozon në Kuvendin e Komunës për miratim.

5. Kryerja e detyrave për zhvillimin e procedurave për ankandin publik dhe procedurave tjera, është në kompetencë të Drejtorisë së Administratës - Zyrës së Prokurimit Publik dhe Drejtorisë së Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës.
6. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komisionit, Drejtorisë së Administratës, Drejtorisë së GJKP dhe Arkivës.




Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi

[Handwritten signature]



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.08.2015

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.07.2015, bazuar në Nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Caktohet Grupi Punues prej tre anëtarëve nga Kuvendi i Komunës, për të ndihmuar në përgatitjen e verzionit përfundimtar të Strategjisë Komunale për Komunikim me Publikun 2015-2019, si vijon:
 - 1.1 Vjollca Konjusha - Anëtare e Kuvendit të Komunës, përfaqësuese e LDK-së;
 - 1.2 Sokol Duraku - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i PDK-së;
 - 1.3 Trandolina Duli - Anëtare e Kuvendit të Komunës, përfaqësuese e LVV-së.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e anëtarëve të Grupit Punues nga legjislativi i komunës është që në bashkëpunim dhe bashkërendim me anëtarët e Grupit Punues: Jakup Tërnavë - Drejtor i Drejtorisë së Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës, Ali Topalli - Zyrtar për Informim dhe Hasan Gjyrevci - Shef për Kuvend dhe Komitete, nga Ekzekutivi dhe Administrata e Komunës, që e kanë hartuar verzionin e parë të Strategjisë Komunale për Komunikim me Publikun 2015-2019, e miratuar në parim nga Kuvendi i Komunës, më datë 30.07.2015, të japin sugjerimet e tyre për inkorporim në verzionin përfundimtar.
3. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Grupit Punues dhe Arkivës.




Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi

[Handwritten signature]



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Komuna e Fushë-Kosovës

STRATEGJIA KOMUNALE PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN 2015-2019

E miratuar në parim në Kuvendin e Komunës

Fushë-Kosovë - 2015

Projekti është financuar nga:



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS

Mbështetur nga OSBE

Përmbajtja:

Ç'është strategjia	
Fjalorthi i shkurtesave.....	
Fjala e Kryetarit të Komunës.....	
Organogrami i Komunës së Fushë-Kosovës.....	
Grupet e synuara / përfituesit	

PJESA E PARË

Hyrja.....	
Detyrimet ligjore për hartimin strategjisë.....	
Strategjia është hartuar në tri baza themelore	
Vizioni dhe objektivat.....	
Objektivat, prioritetet, veprimet e strategjisë	
SWOT ANALIZA.....	
Të dhënat e përgjithshme për Komunën e Fushë-Kosovës.....	
Analiza në fushën e informimit dhe komunikimit.....	

PJESA E DYTË

Plani dinamik.....	
Objektivi i parë: - Krijimi i mënyrave efektive për komunikim.....	
Objektivi i dytë:- Krijimi i komunikimit efektiv dhe ndikimi i qytetarëve në politikat publike.....	
Objektivi i tretë: - Krijimi i mjedisit të përshtatshëm nga pushteti lokal dhe pjesëmarrja aktive e qytetarëve.....	
Buxheti	
Plani dinamik.....	
Plani i monitorimit dhe zbatimit	

Ç'është strategjia

Strategjia është një plan i hartuar për të arritur një qëllim. Institucionet, organizatat, shoqatat dhe kompanitë hartojnë strategji që të paraqesin vizionin e tyre dhe qëllimet. Kjo strategji është shoqëruar me udhëzime operative në: objektivat, prioritet, masat, aktivitete konkrete, rezultate të pritshme, buxhetim dhe monitorim.

Pjesë përbërëse e strategjisë është plani i veprimit për hartim, plani dinamik dhe plani i monitorimit, të cilat përbëjnë mjete të rëndësishme për veprim nga teoria dhe praktika. Në praktikë këta hapa do të nxisin shkëmbimin e informacionit dhe komunikimin e ndërsjellë në mes komunës dhe qytetarëve.

Fjalorthi i shkurtesave

- KPF- Komiteti për Politikë dhe Financa
- ZIP- Zyra për Informim Publik
- AK-Asambleja Komunale
- GP-Grupi punues
- OSBE-ja-Organizata për Siguri, Bashkëpunim në Evropë
- BE-Bashkësia Evropiane



Fjala e Kryetarit të Komunës


Të nderuar qytetar të Komunës së Fushë-Kosovës

Qytetar të nderuar të Komunës së Fushë Kosovës;

Kam kënaqësinë t'ju prezantoj Strategjinë për Informim dhe Komunikim të Komunës së Fushë-Kosovës. Ekzekutivi i Komunës sonë si deri më tash ka dëshmuar për ndërtimin e një qeverisjeje të mirë për të gjithë qytetarët e saj. Kjo qeverisje ka për qëllim të mbështes bashkëpunimin e ndërsjellë qytetar - komunë.

- Për të qenë në shërbim të qytetarëve është kërkuar të ndiqet një dinamikë e zhvillimit socio-ekonomike, e cila nënkupton reformë të vazhdueshme, duke fuqizuar dhe inkurajuar vazhdimisht pjesëmarrjen në vendimmarrje të qytetarit. Për të fuqizuar pjesëmarrjen e qytetarit në proceset vendimmarrëse është parë si domosdoshmëri hartimi dhe miratimi i një strategjie, e cila mbështet dhe qartëson komunikimin në relacion qytetar-komunë.*
- Strategjia Komunale për Informim dhe Komunikim është punuar me përkushtim nga Grupi Punues i Komunës së Fushë Kosovës, mbështetur nga OSBE-ja.*
- Ndërtimi i marrëdhënieve të mira me qytetarin (publikun), është moto e politikës lokale, e cila ka ndikuar në përmirësimin e qeverisjes lokale, me qëllimin që të kemi një qeverisje më transparente, më llogaridhënëse, më të përgjegjshme, me synim për të rritur besimin e ndërsjellë qytetar-komunë.*
- Ky dokument do të jetë një ndihmë e madhe për Zyrën për Informim Publik, e cila zyrë me punën e saj është kujdesur dhe ka siguruar marrëdhënie të mira me qytetarët.*
- Kjo strategji njëkohësisht është ftese për të gjithë qytetarët të jenë të përfshirë për të vendosur prioritetet e tyre gjatë hartimit të buxhetit komunal, zhvillimit ekonomik, planifikimit hapësinor, projektet e investimeve kapitale si dhe përdorimin e mjeteve publike.*
- Ky dokument strategjik, lehtëson kycjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në organet e pushtetit lokal përmes takimeve të ndryshme (debateve publike, asamble komunale, vendbanime, fshatra, lagje, mediave të shkruara dhe elektronike, ueb-faqes, rrjeteve sociale), për dhënien e sugjerimeve, mendimeve, vërejtjeve dhe propozimeve.*
- Në emër të qytetarëve të komunës, të pushtetit lokal, falënderoj të gjithë ata që kontribuan në hartimin e këtij dokumentit të rëndësishëm për qytetarët e komunës sonë.*

Organogrami i Komunës së Fushë Kosovës



Anëtarët e grupit punues:

1. Jakup Tërnavë (ish / Nënkyetar i komunës)
2. Hasan Gjyrevci (Shef për Kuvend dhe Komitete)
3. Ali Topalli (Zyra për Informim)

Grupet e synuara / përfituesit

- Grupet strategjike të synuara përmes kësaj strategjie janë:
- Qytetarët
- Mediat (lokale dhe kombëtare),
- Studentët
- Nxënësit
- Shoqëria civile (OJQ),
- Bizneset
- Grupet marginalizuara
- Fermerët

Hyrja

Strategjia për informim dhe komunikim, është dokument i rëndësishë së veçantë për komunën e Fushë-Kosovës, e cila ka në përmbajtjen e vet rregullimin e fushës së komunikimit dhe informimit me relacionin, komunë - qytetar.

Kjo strategji është një nismë e re dhe përpjekje për të përmirësuar, njëkohësisht për të avancuar komunikimin në mes komunës dhe qytetarit, po ashtu për të mbajtur të mirëinformuar opinionin publik për zhvillimet në komunën e Fushë-Kosovës.

Strategjia ka qëllim për të inkurajuar pjesëmarrjen aktive të qytetareve në aktivitetet komunale, si dhe për të ndërtuar ura lidhëse në mes të këtyre dy aktorëve, për të forcuar lidhjen më synim ngritjen e besimit të pushteti lokal.

Hartimi i kësaj strategjie ka për synim, që të vë në zbatim planet konkrete, për të motivuar pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje. Krijimi i kësaj lidhje me qytetarët e vë komunën përballë vështirësive për gjetjen e mënyrave më të përshtatshme për të informuar dhe komunikuar më qytetarët.

Strategjia për Informim dhe Komunikim, do të ndihmojë planifikimin e punës pesëvjeçare të komunës në këtë fushë.

Komuna e Fushë-Kosovës përmes këtij dokumenti strategjik ofron kushte për një qeverisje të mirëfilltë, me një shoqëri aktive në jetën dhe në çështjet e përgjithshme komunale.

Për realizimin e këtyre objektivave, komuna do të bashkëpunojë ngusht me qytetarët përmes takimeve të ndryshme, mediave të shkruara dhe elektronike, ueb-faqes, rrjeteve sociale (facebook, twiter, youtube, etj).

Dokumenti i strategjisë është ndarë në dy pjesë, ku pjesa parë është tekst shpjegues kurse pjesa e dytë, përfshin planin e veprimit, zbatimit dhe monitorimit të strategjisë.

Metodologjia e cila është përdorur për hartimin e kësaj strategjie është hulumtimi i gjendjes ekzistuese në fushën e informimit dhe komunikimit si dhe obligimet, synimet në funksion të zhvillimit të gjithëmbarshtëm të komunës sonë.

Baza ligjore për hartimin e strategjisë

Në kapitujt e strategjisë shqyrtohen disa aspekte aktuale në fushën e informimit dhe komunikimit. Dokumenti është hartuar në përputhshmëri ligjore të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike, Statutit të Komunës, si dhe akteve të tjera normative.

Strategjia është në harmoni me kriteret e “aquis communautaire” të Bashkimit Evropian, e cila parasheh bashkëpunim ndërmjet pushtit lokal dhe qytetarit. Strategjia përbënë kornizën e përbashkët për të gjithë aktorët ndërmjet komunës me qytetarin, shoqërinë civile, mjetet e informimit, me synim që të arrihen mënyra të shumta të komunikimit.

Komuna e Fushë-Kosovës, ka të miratuar Rregulloren për Transparencë, e cila rregullon, çartëson, detyrat dhe përgjegjësitë e organeve komunale përballë qytetarëve.

Për hartimin e draftit të parë të kësaj Strategjie për Informim dhe Komunikim, është formuar grupi punues, i përbërë nga zyrtarë komunalë dhe përfaqësues të tjerë.

Strategjia është hartuar në tri baza themelore

1. Analiza e gjendjes në fushën e informimit dhe komunikimit

Analiza e gjendjes në fushën e informimit dhe komunikimit paraqet mekanizmat lokal ekzistues, të cilat me kalimin e kohës duhet të ndryshohen përkatësisht të përmirësohen me synim të përmirësimit të komunikimit me qytetarët.

Këta mekanizma në nivel lokal parashikojnë mundësinë e përfshirjes së mëtejme të qytetarëve në funksionimin e komunës, në mënyrë që qytetarët të jenë subjekt dhe pjesëmarrës aktiv në vendimmarrje.

Dokumenti i tillë strategjik është realizuar përmes analizave të gjendjes ekzistuese, Swot Analizës, përmes hulumtimit të të dhënave në dispozicion, grupit punës, debatit publik, etj.

2. Plani i veprimit

Në mënyrë të detajuar janë dhënë prioritetet përkatëse, të cilat përcaktojnë kohën e përmirësimit të komunikimit, të mbështetur në linja buxhetore. Ky plan i veprimit paraqet kornizën kohore dhe aktorët përgjegjës për zbatimin e kësaj strategjie.

Plani i monitormit

Për zbatimin e strategjisë përgjegjëse është Drejtoria e Administratës, ndërsa Zyra për Informim e Publikut do të kujdeset për monitorimin, zbatimin, e këtij dokumenti strategjik, si dhe do të hartojë raporte periodike për të vlerësuar implementimin e kësaj Strategjieje.

Vizioni

Komuna e Fushë-Kosovës, në periudhën pesë vjeçare, ka për qëllim përmirësimin e mekanizmit për informim dhe komunikim, me synim që t'u përgjigjet nevojave (interesave) të qytetarëve.

Përmes kësaj strategjie qytetarët e komunës do të jenë informuar për zhvillimet komunale, për proceset e vendimmarrjes, me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës para qytetarëve dhe institucioneve të tjera relevante.

Me këtë vizion komuna e Fushë-Kosovës synon që, në periudhën pesëvjeçare, të krijojë informim dhe komunikim efektiv me qytetarët dhe pushtetin lokal.

Që të arrihet ky qëllim, duhet të monitorohet në mënyrë periodike, nga mekanizmat institucional si dhe shoqëria civile.

Vizionin e përbëjnë këta faktor:

- A) Qytetar të informuar
- B) Komunikimi
- C) Interesat e qytetarëve
- D) Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm komunal për pjesëmarrje të qytetarëve

Realizimi i kësaj strategjie është bazuar në tre objektiva kryesore me prioritet, si dhe me masat përcjellëse siç vijojnë:

Nr.	Objektivi	Prioritet	Veprimet
1	Krijimi i mënyrave efektive për komunikim	1. Komunikim efektiv nga komuna, më qëllim që shërbimet komunale të jenë sa më afër qytetarit. 2. Mekanizmat ekzistues për dhënien e informacionit tek qytetari. 3. Krijimi i mekanizmave të rinj për dhënien e informacionit. 4. Bashkëpunimi me mediat 5. Informimi i qytetarëve për qasje në dokumentet publike-zyrtare.	• Drejtoritë komunale, asambleja dhe komitetet në kuadër të asamblesë, ofrojnë informacione për shërbimet komunale te Zyra për Informim Publik, në mënyrë që shërbimet të prezantohen në ueb-faqe të komunës (aplikacionet online), Etj. • Ngritja e kapaciteteve të administratës komunale për informim të qytetarëve. • Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare në fushën informative • informimi i qytetarëve për shërbimet komunale përmes fletëpalosjeve, broshurave, ueb faqes, rrjeteve sociale etj. • Vendosja e tabelave informuese në pesë vendbanime të mëdha.
2	Krijimi i komunikimit efektiv dhe ndikimi i qytetarëve në politikat publike	1. Debate me qytetar para marrjes së vendimeve të ndryshme. 2. Debatet me qytetarët, gjatë fazës së hartimit të buxhetit të komunës. 3. Takime të rregullta me qytetar. 4. Krijimi i mekanizmave të rinjë për informim dhe komunikim me qytetar.	• Konsultime me grupe të ndryshme të interesit para aprovimit të akteve normative. • Konsultim me grupe përkatëse të interesit para aprovimit të vendimeve dhe planeve komunale. • Publikimi i orarit të takimeve të rregullta me qytetarë Zyra e kryetarit, kryesuesit të asamblesë dhe drejtoritë komunale . • Komunikimi interaktiv qytetar-komunë përmes rrjeteve sociale.
3	Krijimi i mjedisit të përshtatshëm komunal për pjesëmarrje aktive të qytetarëve.	• Mbështetja e iniciativave të qytetarëve. • Organizimi i manifestimeve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.	• Ndarja e mjeteve buxhetore për mbështetje të iniciativave qytetare. • Hapja e rubrikës në ueb faqe për pyetje, kërkesa dhe sugjerime nga qytetarët. • Manifestime të ndryshme (Përvjetorë, Dita e Pavarësisë, Dita Botërore e Ujit, Dita e Mjedisit, 12 Qershori - Dita e Çlirimit, etj. • Manifestime me qytetar (Muaj i Diasporës), etj.

Swot Analiza

Përparësitë


- Komuna ka përvojë në informimin e qytetarëve – Zyra për Informim Publik;
- Sistemi i zhvilluar i informimit përmes rrjeteve sociale;
- Sistemi i informimit me anë të tabelave informuese, monitorit (LSD), fletëpalosjeve, njoftimeve në radio, tv, etj.;
- Debateve publike në komunë dhe zonat rurale.

Mundësitë

- Përvoja dhe qasja profesionale në fushën e informimit, komunikimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse;
- Kornizat ligjore dhe akteve normative të përshtatshme për informim, komunikim dhe pjesëmarrje të qytetarëve në proceset vendimmarrëse;
- Ligji për qasje në dokumentet publike-zyrtare;
- Bashkëpunimi i qytetarëve në forcimin e komunikimit me komunën (në sektor të ndryshëm).

Rreziqet

- Mosinteresimi i mjaftueshëm i qytetarëve për të drejtën në qasje në dokumentet publike;
- Mungesa (në një masë) e televizioneve dhe radiove lokale;
- Mungesa e mjeteve financiare për një zhvillim të avancuar të sistemit të informimit-komunikimit me publikun;
- Mosinteresimi i qytetarëve – neglizhenca;
- Përkushtimi jo i mjaftuar i OJQ-ve lidhur me fushën e informimit- komunikimit në funksion të sensibilizimit të temave të caktuara.



Të dhënat e përgjithshme për komunën e Fushë-Kosovës

- Komuna e **Fushë-Kosovës** gjendet në pjesën qendrore të Kosovës. Është në një distancë ajrore prej 6.6 km në perëndim të kryeqytetit të Kosovës. Kufizohet me komunat e Prishtinës, Obiliqit, Drenasit, Lipjanit dhe Graçanicës. Shtrihet në mes të Rrafshit të Kosovës. Ky territor i Komunës së Fushë-Kosovës ka një sipërfaqe prej 9517,04 ha.

Nëpër Komunën e Fushë Kosovës kalon Rruga Regjionale - M9, që lidh këtë komunë me Komunën e Prishtinës, dhe Pejës. Me rrugë të nivelit më të ulët komuna e Fushë-Kosovës ka lidhje direkte edhe me Lipjanin, Obiliqin e Drenasin. Drejtimi meridian i rrugës që lidh kryeqendrën me Selanikun, Shkupin e Beogradin, kryqëzohet me Rrugën - M9 përkaj qytetit dhe komunës së Fushë-Kosovës, gjë që rrit potencialin gjeostrategjik të komunës.

Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, komuna e Fushë-Kosovës ka 34 718 banorë.

Analiza e fushës së informimit dhe komunikimit

Zyra për Informim Publik, që nga themelimi i saj, ka ndërtuar marrëdhënie të mira me publikun. Zyra ka siguruar informim të vazhdueshëm për të gjithë qytetarët e komunës dhe më gjerë. Kjo zyrë, pas miratimit të Rregullores Komunale për Sistematizimin e Vendeve të Punës, vepron në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës. Udhëhiqet nga zyrtari/ja për informim publik, i/e cila ka këto detyra dhe përgjegjësi, të:

- Ofrojë qytetarëve të komunës informatat të rregullta përmes medieve;
- Organizon kontakte të rregullta me masmedia, konferenca për shtyp, në baza periodike, lëshon njoftime dhe komunikata për shtyp;
- Bashkërendon kontakte në mes të zyrtarëve komunalë dhe mediave;
- Përpilon dhe mirëmban faqen zyrtare të internetit të komunës në dy gjuhë zyrtare (d.m.th. përfshin informata për aktivitetet komunale, raportet, kalendarin e takimeve, regjistrin e numrave të telefonit dhe informatat kontaktuese të zyrtarëve komunalë);
- Bashkërendon veprimet (me drejtoritë e komunës) në harmoni me dokumentet komunale dhe promovon (p.sh.: broshurat dhe afishet për qytetar, rreth shërbimeve ngjarjeve komunale);
- Siguron informatat nga shtypi (lajmërimet për mbajtjen e takimeve, informatat për vendimet që janë marrë), nga të gjitha ngjarjet komunale, siç janë takimet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të saj;
- Peticionet publike dhe kërkesat për informata për aktivitetet komunale;
- Jep mbështetje aktive drejtorive komunale, Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij, në koordinimin, organizimin, zbatimin dhe prezantimin në terren të aktiviteteve komunale.

Zyra për Informim Publik bashkëpunon dhe mban kontakte me zyrtarët komunalë, informon palët e interesit. Mbështet fushatat mediale për çështjet përkatëse komunale.

Arkivon fotografi, raporte, komunikata për shtyp, etj. Organizon dhe bashkërendon konsultimet publike. Mbështet në kontinuetitet dëgjimet publike para miratimit të akteve komunale.

Zyra për Informim Publik, pasqyron vazhdimisht aktivitetet e zhvilluara në gjithë hapësirën komunale. Të gjitha aktivitetet që zhvillohen në komunë njoftohen përmes:

- ✓ Tabelës së njoftimeve
- ✓ Web-sajtit të komunës
- ✓ Monitorit
- ✓ Faqes së internetit, ose
- ✓ Zyrës për Informim Publik

Përcjellja e të gjitha aktiviteteve që zhvillohen brenda dhe jashtë komunës është përgjegjësi me peshë për punën e zyrtarit për informim publik. Në numër të pamjaftueshëm të stafit të punës Zyra për Informim Publik, do të duhej të kishte staf shtesë për të përballuar angazhimet dhe kapacitetin e madh të detyrave dhe përgjegjësi që dalin nga kjo strategji.

Për zbatimin e kësaj Strategjie për Informim dhe Komunikim, zyra duhet të angazhohet për të arritur këto objektiva:

- Komuna të jetë më afër qytetarit
- Lidhja e qytetarit më shërbimet komunale
- Qytetarët pjesë e sistemit vendim marrës
- Komunikim i përhershëm me qytetarin
- Botimi i fletëpalosjes, broshurës për aktivitet e komunës dhe anasjelltas
- Botimi i raportit për gjashtëmujorin e parë dhe të dytë
- Informacionet relevante për punën e komunës dhe të drejtat e qytetarëve, (do të përmbliidhen në një broshurë informative, e cila do të botohet dy herë në vit).

Në kuadër të Zyrës për Informim Publik vepron edhe ueb-faqja e komunës, e krijuar që nga viti 2010. Kjo ueb-faqe zyrtare u mundëson qasje më të lehtë qytetarëve në ngjarjet komunale. Postimi i vazhdueshëm i dokumenteve dhe ngjarjeve të rëndësishme, që janë në interes për qytetarët e komunë së Fushë-Kosovës.

Prej krijimit të ueb-faqes dhe standardizimit të saj, kjo ueb-faqe ka rritur interesimin e qytetareve për përcjelljen e aktiviteteve të pushtetit lokal.

Rol të rëndësishëm në informim dhe komunikimin më qytetarin dhe opinionin e gjerë luajnë edhe rrjetet sociale.

Për të siguruar bartje të shpejtë dhe efektive të informacionit zyrtar, Zyra për Informim Publik, përveç ueb-faqes (ueb- portalit) do të krijojë profilet zyrtare në rrjetet sociale si you-tybe dhe Twiter. Përmes këtyre profileve, qytetarëve do t'u ofrohet informacion në baza ditore për punën dhe zhvillimet në komunë.

Aktivitet dhe ngjarjet lokale herë pas here mbulohen nga korrespondentët, ku burim i informatës dhe komunikimit për ta është Zyra për Informim Publik.

Territori i komunës mbulohet mjaft mirë nga televizionet kombëtare dhe ato rajonale, që kanë shikueshmëri të mirë.

Komuna mban edhe takime më qytetar në formë të debateve publike, si dhe bashkëpunon më qytetarët si partnerë për realizimin e projekteve më interes të përgjithshëm.

Strategjia ka tre objektiva kryesor:

Objektivi i parë1: Krijimi i mënyrave efektive për komunikim

Më këtë objektivë, komuna e Fushë-Kosovës synon të ofrojë mënyra më të lehta të komunikimit më qytetarët përmes publikimit të formularëve drejtpërsëdrejti (online), botimit të materialeve informuese dhe promovuese.

Objektivat strategjik	Prioritet	Veprimet
<u>Objektiva 1:</u> Krijimi i mënyrave efektive për komunikim	Prioriteti 1: Komunikim efektiv, me qëllim që shërbimet komunale të jenë sa më afër qytetarit	Veprimi 1: Drejtoritë komunale, asambleja dhe komitetet e saj të ofrojnë informacione për shërbimet komunale tek Zyra për Informim Publik, në mënyrë që këto shërbime të prezantohen në ueb faqe të komunës (aplikacionet online), etj.
		Veprimi 2: Drejtoritë komunale të ofrojnë informacione tek ZIP për iniciativat, aktivitetet për punimet ndërtimore, zhvillimin ekonomik, administratën, buxhetin dhe financat, arsimin, shëndetësinë, gjithashtu edhe për aktivitetet e përbashkëta me organizatat joqeveritare, etj.
		Veprimi 3: Drejtoritë komunale të ofrojnë informata për përmbyllje të suksesshme të ndonjë projektit tek ZIP, në mënyrë që qytetari të informohet për sukseset e komunës.
		Veprimi 4: Informimi i mërgatës për arriturat e komunës (ueb faqes, fletushkave, broshurave) etj.
		Veprimi 5: Ngritja e kapaciteteve të administratës komunale për informim të qytetarit. Pajisja me teknologji informative të avancuar.
		Veprimi 6: Ngritja e kapaciteteve të ZIP, për informim të qytetarit. Zgjerimi i stafit dhe pajisja me teknologji informative
	Prioriteti 2: Mekanizmat ekzistues të dhënies së informacionit për qytetarët	Veprimi 1: Ri-freskimi i ueb faqes me informata
		Veprimi 2: Përdorimi i rrjeteve sociale për dhënien e informatave për qytetarin

		<u>Veprimi 3:</u> Publikimi i informacioneve në tabela informuese.
		<u>Veprimi 4:</u> Publikimi i fletëpalosjeve, broshurave dhe panove.
		<u>Veprimi 5:</u> Takime më qytetar në hapësirën komunale dhe zonat rurale.
	Prioriteti 3: Krijimi i mekanizmave të rinj për dhënien e informacionit	<u>Veprimi 1:</u> Publikimi i raportit për çdo gjashtë muaj për aktivitetet e komunës.
	Prioriteti 4: Bashkëpunimi me mediat e tjera	<u>Veprimi 2:</u> Fushata të përbashkëta informuese me organizatat joqeveritare.
		<u>Veprimi 3:</u> Publikimi i materialeve promovuese të trashëgimisë natyrore-kulturore, turizëm, etj.
		<u>Veprimi 4:</u> Shpërndarja e informatave në mediat lokale, kombëtare, përmes komunikatave (radio, gazeta, portale informuese).
	Prioriteti 5: Informimi i qytetarit për qasje në dokumentet publike	<u>Veprimi 5:</u> Organizimi i emisioneve në radio dhe televizione.
		<u>Veprimi 1:</u> Informimi i qytetarëve për shërbimet komunale nëpërmjet fletëpalosjeve dhe broshurave.
		<u>Veprimi 2:</u> Publikimi i manualeve për qasje në dokumentet publike.
		<u>Veprimi 3:</u> Publikimi i raporteve statistikore të shërbimeve.

Projekti 1:

Objektivi 1: Krijimi i mënyrave efektive për komunikim			
Prioriteti 2: Komunikim efektiv, më qëllim që zhvillimet komunale të jenë sa më afër qytetarit			
Prioriteti 3: Mekanizmat ekzistues të dhënies së informacionit për qytetarin			
Qëllimi i projektit		Rezultatet e pritura	Buxheti
Zhvillimet komunale të jenë më afër qytetarëve		Qytetar më të informuar	3200€
Kohëzgjatja e implementimit	Planifikimi i kostos financiare	Përgjegjësitë	Përfituesit
	N/A	Kryetari, Drejtoritë Zyrtari për Informim	Të gjithë qytetarët
Detyrat, veprimet		Afati	Planifikimi i kostos financiare Resurset
1. Vendimet e Kryetarit për drejtoritë		Janar - Qershor	Zyra e Kryetarit të Komunës
2. Vendorsja e informacioneve, shërbimeve dhe aplikacioneve		Janar - Qershor	ZIP dhe drejtoritë përkatëse
3. Drejtoritë komunale të ofrojnë informacione të ZIP për iniciativat, aktivitetet për investimet kapitale, zhvillimin ekonomik, administratën, buxhetin financiar, arsimin dhe shëndetësinë, gjithashtu edhe për aktivitetet e përbashkëta me organizatat joqeveritare, etj.		Janar - Qershor	ZIP dhe drejtoritë përkatëse

4. Informimi i qytetarëve për shërbimet komunale përmes fletëpalosjeve dhe broshurave.	Janar - dhejtor		ZIP dhe drejtoritë përkatëse
5. Ngritja e kapaciteteve të administratës komunale për informim të qytetarit.	Janar - Dhjetor		ZIP dhe drejtoritë përkatëse
6. Ngritja e kapaciteteve të Zyrës për Informim Publik	Qershor - dhjetor		ZIP dhe drejtoritë përkatëse

Objekti 1: Krijimi i mënyrave efektive për komunikim

7. Mirëmbajtja e ueb-faqes komunale: • Dokumentet komunale • Publikimi i planit vjetor të punës, akteve të miratuara dhe procesverbaleve nga Kuvendi i Komunës. • Publikimi i 'Planit vjetor të punës të administratës komunale'. • Publikimi i vendimeve të tjera komunale. • Publikimi i informacioneve për shërbimet komunale. • Publikimi i listës së shërbimeve të ofruara për kushtet, çmimet dhe dokumentet e nevojshme për shërbimet e ofruara. • Formularët e të gjitha llojeve të kërkesave dhe parashtresave (ankesa). • Modelet e dokumenteve të plotësuara. • Formularët e përshtypjeve dhe komenteve të qytetarëve për shërbimet e ofruara.			ZIP dhe drejtoritë përkatëse
8. Përdorimi i rrjeteve sociale për dhënie të informacionit për qytetarin- (Facebook, Youtube, Tweeter) • Të gjitha informacionet rreth shërbimeve, lajmet, kronikat, të arriturat të publikohen në facebook. • Të publikohen, fletëpalosje, broshurat, posterët dhe publikimet të tjera.	Janar - Dhjetor		ZIP dhe drejtoritë përkatëse

9. Publikimi i informacioneve në tabela informuese. • Publikimi dhe rifreskimi i informacioneve në tabelat informuese, siç janë: shpallje, konkurse, poster, ftesa, njoftime etj.	Janar - Dhjetor		ZIP dhe drejtoritë përkatëse
10. Publikimi i fletëpalosjeve, broshurave: • Publikimi i broshurave për informim në fusha me interes për qytetarët, siç janë: ‘Broshura për shpenzimet dhe planifikimin e buxhetit të komunës’. • ‘Broshura për taksa dhe tarifatat për komunën’. • ‘Broshura për qasje në dokumentet zyrtare’. • Broshura të tjera, të cilat japin informacione konkrete për qytetarët, në fushën e shëndetësisë, arsimit, ekonomisë dhe planifikimeve ndërtimore. • ‘Broshura për trashëgiminë kulturore dhe natyrore’, etj.	Janar - Dhjetor		ZIP dhe drejtoritë përkatëse

Projekti 2:

Objektivi 1: Krijimi i mënyrave efektive për komunikim

Prioriteti 3: Krijimi i mekanizmave efektiv për dhënien e informacionit

Prioriteti 4: Bashkëpunimi me mediat

Qëllimi i projektit		Rezultatet e pritura	Buxheti		
Krijimi i mekanizmave efektiv për dhënien e informacionit			3200€		
Bashkëpunimi me mediat					
Kohëzgjatja e implementimit	Planifikimi i kostos financiare	Përgjegjësitë	Përfituesit		
		Kryetari, Drejtoritë, Zëdhënës –i/ja për Informim Publik	Të gjithë qytetarët		
Detyrat / Masat			Afati	Shpenzimet	Resurset
Vendosja e tabelave informuese në bashkësitë lokale			Janar - Djetor		ZIP dhe drejtoritë përkatëse
Hartimi i planit për mirëmbajtjen e tabelave informuese			Qershor - shtator		ZIP dhe drejtoritë përkatëse
Hartimi i kalendarit vjetor për planifikim të aktiviteteve komunale			Janar - Dhjetor		ZIP dhe drejtoritë përkatëse
Publikimi i raportit periodik			Janar - Dhjetor		ZIP dhe

			drejtoritë përkatëse
Publikimi i materialeve promovuese të trashëgimisë kulturore, natyrore dhe turizëm.	Janar - Dhjetor		ZIP dhe drejtoritë përkatëse
Shpërndarja e informatave në mediat lokale, nacionale përmes komunikatave.	Sipas nevojës		ZIP dhe drejtoritë përkatëse
Fushata të përbashkëta informuese me organizatat joqeveritare.	Sipas nevojës		ZIP dhe drejtoritë përkatëse
Organizimi i emisioneve në radio dhe televizione lokale.	Sipas nevojës		ZIP dhe drejtoritë përkatëse

Objektivi 2: Krijimi i komunikimit efektiv dhe ndikimi i qytetarëve në politikat publike

Me anë të këtyre objektivave, synojmë që të arrijmë një mënyrë më të lehtë të komunikimit në mes qytetarëve dhe komunës.

Objektivat strategjike	Prioritetet	Veprimet
Objektivi 2: Krijimi i komunikimit efektiv dhe ndikimi i qytetarëve në politikat publike	Prioriteti 1: Debate me qytetar para marrjes së vendimeve të ndryshme.	<u>Veprimi 1:</u> Debate vjetore me biznese, grupe të ndryshme të interesit, para aprovimit të akteve normative. <u>Veprimi</u> me grupe të ndryshme të interesit, para aprovimit të akteve administrative.
	Prioriteti 2: Debate me qytetar gjatë fazës së hartimit të buxhetit.	<u>Veprimi 1:</u> Hartimi i planit të veprimit për transparencë në Kuvend. <u>Veprimi 2:</u> Organizimi i dëgjimeve publike në secilin vendbanim, fshat. <u>Veprimi 3:</u> Debate publike sipas nevojës që iu përgjigjen nevojave dhe kërkesave të qytetarëve.
	Prioriteti 3: Takime të rregullta me qytetar	<u>Veprimi 1:</u> Caktimi dhe publikimi i orarit të takimeve të rregullta me qytetar (Zyra e Kryetarit dhe Drejtoritë Komunale). <u>Veprimi 2:</u> Ditët e Diasporës, Java e Maturantëve, Ditët e Trashëgimisë Kulturore, Organizimet kulturore multietnike. <u>Veprimi 3:</u> Përdorimi i ueb-faqes komunale, si mjet për marrjen e informacioneve nga qytetarët.
		<u>Veprimi 1:</u> Paraqitja e ankesave të qytetarëve në Kutinë për Ankesa, e vendosur në hapësirën e komunës.

	Prioriteti 4: Krijimi i mekanizmave të rinj për informim dhe komunikim	<u>Veprimi 2:</u> Përdorimi i ueb-faqes komunale, si mjet për marrjen e informacioneve. <u>Veprimi 3:</u> Lehtësimi i komunikimit nëpërmjet rrjeteve sociale (Facebook-ut). <u>Veprimi 4:</u> Pajisja e administratës me mjetet teknologjike. <u>Veprimi 5:</u> Pajisja e Zyrës për Informim Publik me mjete teknologjike dhe zgjerim të stafit punues. <u>Veprimi 6:</u> Trajnime për stafin administratës në fushën e teknologjisë së dhënies së informacionit. <u>Veprimi 7:</u> Vizita studimore në regjion për shkëmbim përvojave.
--	---	---

Objektivi 2: Krijimi i mënyrave për komunikim dhe ndikim në politikat publike

Prioriteti 1: Debate me qytetar para aprovimit të vendimeve, të cilat do të ndikojnë në përmirësimin mirëqenies së qytetarëve.

Prioriteti 2: Debate me qytetarët para hartimit të buxhetit të komunës.

Prioriteti 3: Takime të rregullta me qytetar.

Prioriteti 4: Krijimi i mekanizmave të rinj për informim dhe komunikim.

Qëllimi i projektit		Rezultatet e pritura	Buxheti		
Rritja e komunikimit dhe debateve me qytetar para marrjes së vendimeve komunale.				3150€	
Kohëzgjatja e implementimit	Planifikimi i kostos financiare	Përgjegjësitë	Përfituesit		
Janar - Dhjetor	N/A	Zyra për Informim Publik, Drejtoritë	Grupet e interesit (bizneset, rinia, gratë) OJQ të gjithë qytetarët e komunës, etj.		
Detyrat, veprimet		Afati	Planifikimi i kostos	Resurset	
Debate me biznese dhe qytetar, para aprovimit të vendimeve dhe akteve normative.		Dhjetor - Janar		Drejtoria e Tatimit në Pronë	
Debate me qytetarët para miratimit të buxhetit të komunës. Organizimi i dëgjimeve publike në vendbanime të mëdha. Publikimi i fletëpalosjeve për aprovimin e buxhetit komunal.		Qershor - Shtator		Kuvendi i Komunës (KPF), Kryetari, Drejtoria e Financave, Drejtoria e Administratës dhe ZIP	

Takimet e rregullta me qytetar Organizimi i dy takimeve publike të cilat parashihen në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Caktimi dhe publikimi i orarit të takimeve të rregullta me qytetar. (Me Kryetar të Komunës, Kryesuesin e Kuvendit të Komunës dhe drejtoritë)	Qershor dhe Nëntor të vitit përkatës Janar të vitit përkatës Janar - Dhjetor		Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, drejtoritë komunale dhe ZKP Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, drejtoritë komunale dhe
Krijimi i mekanizmave të rinj për informim dhe komunikim	Janar - Dhjetor		ZKP
Pajisja e administratës me mjete teknike dhe teknologjike	Janar - Dhjetor		
Pajisja Zyrës për Informim Publik me mjete teknike dhe teknologjike	Janar - Dhjetor		
Zyra për Informim Publik, zgjerimi i stafit të punës	Janar - Dhjetor		

Objektivi 1: *Krijimi i mekanizmave për marrjen e informacionit nga qytetarët*

Prioriteti 3: Krijimi i mënyrave të reja për marrje të informacionit nga qytetarët

Qëllimi i projektit		Rezultatet e pritura	Buxheti
Komunikimi përmes debateve me qytetar, para marrjes së vendimeve komunale			3150€
Kohëzgjatja e implementimit	Planifikimi i kostos financiare	Përgjegjësitë	Përfituesit
		Kryetari, drejtoritë	Të gjithë qytetarët

		Zëdhënësi për Informim Publik			
Detyrat, veprimet			Afati	Shpenzimet	Resurset
Përdorimi i ueb-faqes komunale, si mjet për marrjen e informacioneve nga qytetarët: Hapja e rubrikës për pyetje, kërkesa dhe sugjerime nga qytetarët			Janar - Dhjetor		ZIP dhe TI
Emisione të drejtpërdrejta në radiot lokale Emisione të udhëheqjes komunal në TV lokal dhe kombëtare			Sipas nevojës		ZIP dhe TI
Shfrytëzimi efikas i rrjeteve sociale (Facebook) Lidhja funksionale e Facebook me ueb-faqe të komunës			Janar- dhjetor		ZIP dhe TI

Objektivi 3 : Krijimi i mjedisit të përshtatshëm për pjesëmarrje aktive

Përmes këtij objekti, Komuna e Fushë-Kosovës, synon krijimin e mënyrave për pjesëmarrje aktive të qytetarëve në projektet e ndryshme me synim të përmirësimit të standardit të qytetarëve.

Objektivi strategjik	Prioritet	Veprimet
Objektivi 1: Krijimi i mjedisit të përshtatshëm për pjesëmarrje aktive të qytetarëve	Prioritet 1: Mbështetja e iniciativave të qytetarëve	Veprimi 1: Ndarja e mjeteve buxhetore për mbështetje të iniciativave qytetare
	Prioritet 2: Mbështetja e OJQ-ve	Veprimi 2: Ndarja e mirënjohjeve

Objektivi 1: Krijimi i mjedisit të përshtatshëm për pjesëmarrje aktive të qytetarëve

Prioriteti 1: Mbështetja e iniciativave të qytetarëve

Prioriteti 2: Mbështetja e OJQ-ve

Qëllimi i projektit		Rezultatet e pritura	Buxheti
Komunikimi dhe konsultimi me qytetar para marrjes së vendimeve komunale			3150€
Kohëzgjatja e implementimit	Planifikimi i kostos financiare	Përgjegjësitë	Përfituesit
		Kryetari, Kuvendi, drejtoritë përkatëse dhe ZIP	Të gjithë qytetarët

Detyrat , veprimet	Afati	Shpenzimet	Resurset
Hartimi për ndarjen e mirënjohjeve iniciativat e qytetarëve Ndarja e mjeteve buxhetore Emërimi i komisionit vlerësues Përgatitja e dokumentacionit për mirënjohje me kritere përkatëse për nominim	Janar - Dhjetor		ZIP dhe TI
Mirënjohje për persona nga fusha e: artit, kulturës, aktivist të fushave të ndryshme, OJQ, etj.	Janar - Dhjetor		ZIP
Ceremonia e ndarjes së mirënjohjeve	Janar - Dhjetor		ZIP

Buxheti

Shpenzimet vjetore		2015	2016	2017	2018	2019
Objektivi i parë: Krijimi i mënyrave efektive për komunikim						
Projekti 1:	Botimi fletëpalosjeve, broshurave, botimi i strategjisë					
Projekti 2:	Vendosja e tabelave informuese në fshatrat më të mëdha					
Projekti 3:	Mirëmbajta e tabelave					
Projekti 4:	Trajnimi i stafit të administratës					
Projekti 5:	Vizita studimore në regjion për shkëmbim përvojave					
Sub-Totali:		400€	1500€	1500€	1500€	1500€
Objektivi i dytë: Krijimi i komunikimit efektiv dhe ndikimi i qytetarëve në politikat publike						
Projekti 1:	Botimi i kalendarit vjetor					
Projekti 2:	Raporti gjashtëmuor					
Projekti 3:	Botimi i materialeve promovuese të trashëgimisë kulturore dhe natyrore					
Sub-totali:		300€	1500€	1500€	1500€	1500€
Objektivi i tretë: Krijimi i mjedisit të përshtatshëm komunal për pjesëmarrje aktive të qytetarëve						
Projekti 1:	Mirënjohjet					
Projekti 2:	Ceremonitë e mirënjohjeve					
Projekti 3:	Pajisjet tekniko - teknologjike					
Projekti 4:	Mjete tekniko - teknologjike për Zyrën e Informimit					
Sub-Totali:						
Total		300€	1500€	1500€	1500€	1500€

Plani dinamik

[illegible]

Plani i monitorimit dhe zbatimit

Indikatorët		Analizimi dhe raportimi				Arritja e qëllimit				
Treguesit	Përcaktimi i treguesit	Burimi i të dhënave	Koha e grumbullimit të dhënave	Personi përgjegjës	Të dhënat bazë	2015	2016	2017	2018	2019
Vizioni: Komuna e Fushë-Kosovës, në periudhën pesëvjeçare, ka për qëllim përmirësimin e mekanizmit për informim dhe komunikim, me synim që t'u përgjigjet nevojave (interesave) të qytetarëve.										
Objektivi 1: Krijimi i mënyrave efektive për komunikim										
Numri i mekanizmave brenda komunës	Web faqja e komunës	Komuna	Çdo ditë	ZIP	1	√	√	√	√	√
Numri i fletëpalosjeve, broshurave, publikimi i strategjisë	Web faqja e komunës	Komuna	Qershor - Dhjetor	ZIP	100	√	√	√	√	√
Tabelat informuese	fshatrat	Komuna	Mars - Prill	ZIP	10	√				
Objektivi 2: Krijimi i komunikimit efektiv dhe ndikimi i qytetarëve në politikat publike										
Takimet publike	pjesëmarrja	Komuna	Çdo muaj	ZIP	3	√	√	√	√	√
Shpalljet për dëgjime publike	pjesëmarrja	Komuna	Çdo muaj	ZIP	10	√	√	√	√	√
Numri i kërkesave të qytetarëve	Kërkesa të qytetarëve që do të përfshihen në buxhetin komunal	Komuna	Janar – qershor Qershor-dhjetor	KPF, ZIP	15	√	√	√	√	√
Objektivi 3: Krijimi i mjedisit të përshtatshëm komunal për pjesëmarrje aktive të qytetarëve										
Numri iniciativave qytetarëve	OJQ	Komuna	Sipas nevojë	ZIP, OJQ	2	√	√	√	√	√
Iniciativat të ndryshme të mbështetura nga komuna për trashëgimi kulturore dhe natyrore, etj.	Komuna	Komuna, OJQ	Mars, Qershor, Korrik, Tetor, Nëntor	ZIP	3	√	√	√	√	√

Shuma totale për zbatimin e 'Strategjisë komunale për komunikim me publikun', për periudhën pesëvjeçare është 19,000.00€ për tri objektivat e saj.

Me respekt!

Grupi Punues Komunal



Kryetari i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi